

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Baza ligjore: Neni 761 dhe vijues K.Civil

Në Tiranë, sot më datë 25/12/2017, ne seline e shoqërisë "NOVA-E" SH.P.K. (në vijim referuar si "*Shoqëria*"), e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në datë 03.03.2016 me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" u hartua një kontratë shitje aksionesh:

NE CILESINE E PALEVE:

SHITESI

1. Z. Mamo Musaj, i biri i Shabanit, lindur me 22.08.1993 në Lushnjë, madhor e me zotësi të plote juridike, i cili ketu e me poshte dote quhet SHITESI

BLERESI

2. Z. Ervis Dyrmishi, i biri i Fatmirit, lindur me 12.06.1987 në Tiranë, madhor e me zotësi të plote juridike, i cili ketu e me poshte do të quhet BLERESI

Palet e mesiperme pas një marrëveshje paraprake midis tyre po hartojnë këtë kontratë :

- Shitesi, Z. Mamo Musaj zotëron 100% (njëqindpërqind) të kuotave pjesëmarrëse në kapitalin e shoqërisë "NOVA-E" sh.p.k të shprehur me një kontratë në para prej 100 Leke (njëqind leke) dhe numër numër kuotash 1 (një kuotë).

Mbeshtetur në Vendimin Nr 4 datë 25/12/2017 të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "NOVA-E" sh.p.k si dhe në Statutin e saj është vendosur që

- Shitesi Z. Mamo Musaj ia shet kuotat e tij pjesëmarrëse në shoqërinë "NOVA-E" sh.p.k blerësit Z. Ervis Dyrmishi. Respektivisht 100% të kuotave me një cmim shitje prej 100 Leke dhe në numër kuotash 1 (një kuotë) dhe deklaron se kuotat e kapitali objekt i kësaj kontrate janë të lira nga çdo lloj pengu, sekuestro, hipotekë apo barre ligjore.

- Blerësi Z. Ervis Dyrmishi pranon të blejë kuotat pjesëmarrëse të shoqërisë "NOVA-E" sh.p.k nga shitesi Z. Mamo Musaj. Respektivisht 100% të kuotave me një cmim shitje prej 100 Leke dhe në numër kuotash 1 (një kuotë) dhe merr përsipër të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që burojnë nga kjo kontratë shitje kuotash.

- Palet në këtë kontratë shitje kuotash deklarojnë se blerësi Z. Ervis Dyrmishi ka bërë likuidimin e kuotave për cmimin e shitjes prej 100 leke (njëqind leke), (në numër 1 kuotë) dhe për këtë të dyja palet nuk kanë asnjë kundërshtim.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate të shitjes së kuotave, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që gezonte shitesi Z. Mamo Musaj në kapitalin e shoqërisë "NOVA-E" sh.p.k transferohen në favor të blerësit Z. Ervis Dyrmishi duke e çliruar shitesin Z. Mamo Musaj nga çdo e drejtë dhe detyrim në shoqërinë "NOVA-E" sh.p.k.

Kjo kontratë është hartuar në dy kopje, nga një për secilën palë, dhe u firmos me vullnetin e tyre të lirë.

PALA SHITESE

Z. Mamo Musaj

PALA BLERESE

Z. Ervis Dyrmishi